

LIGJI NR. 04/L-240

PËR MASAT ANTIDAMPING DHE MASAT KUNDËRBALANCUESE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR
MASAT ANTIDAMPING DHE MASAT KUNDËRBALANCUESE**

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Më këtë ligj përcaktohen rregullat dhe procedurat për vendosjen e masave antidamping ndaj importeve, të cilat janë objekt i dampingut, si dhe masave kundërbalancuese ndaj importeve të subvencionuara, me qëllim të mbrojtjes së industrisë vendore dhe interesave të Republikës së Kosovës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet për masat antidamping dhe kundërbalancuese kundër një produkti të importuar, i cili është i dampuar apo përfitues nga subvencionet e Qeverisë ose një autoritet publik i vendit eksportues ose vendit të origjinës, me kusht që ky import i një produkti shkakton ose kërcënon të shkaktojë dëm material ndaj industrisë vendore të Republikës së Kosovës.

2. Masat antidamping dhe/ose kundërbalancuese vendosen vetëm pas respektimit të procedurave përkatëse dhe kryerjes së hetimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Kosova** - Republikën e Kosovës;

1.2. **Ministria** - Ministrinë përkatëse për Tregti dhe Industri;

1.3. **Komisioni** - Komisionin e Vlerësimit të Detyrimeve të Veçanta të Importit të përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji;

1.4. **GATT** - Marrëveshjen e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë të vitit 1994;

1.5. Produkt nën hetim - Produktin e importuar në Kosovë i cili është objekt i një hetimi për damping ose subvencionim;

1.6. Produkti me karakteristika identike, p.sh. i ngjashëm në të gjitha aspektet me produktin nën hetim, apo në mungesë të një produkti të tillë ndonjë produkt tjetër i cili edhe pse nuk është i ngjashëm në të gjitha aspektet ka shumë karakteristika të ngjashme me ato të produktit nën hetim, një kriter ky i rëndësishëm kur këto dy produkte konkurrojnë njëra tjetrën apo janë të zëvendësueshme;

1.7. Vend eksportues - Vendin e origjinës së produktit nën hetim. Në disa raste ky mund të jetë edhe një vend ndërmjetës, përveç kur produkti kalon vetëm transit nëpër vendin ndërmjetës ose nuk ka qenë të paktën pjesërisht i prodhuar në vendin ndërmjetës apo kur nuk mund të ketë një çmim të krahasueshëm në këtë vend;

1.8. Çmimi i eksportit - Çmimin realisht të paguar ose që duhet të paguhet për produktin nën hetim, kur shitet për eksport nga vendi eksportues në Kosovë;

1.9. Vlera normale - Çmimin e krahasueshëm për produkt të ngjashëm, të paguar ose që duhet të paguhet nga blerësit e parë të pavarur në kushte normale të tregut, kur është i destinuar për konsum në vendin e origjinës ose eksportit;

1.10. Dampingu - Importin e mallrave në Kosovë me një çmim më të ulët të eksportit sesa çmimi i krahasueshëm për produktin e ngjashëm të destinuar për konsum nën kushtet normale të tregut në vendin eksportues;

1.11. Marzha e dampingut - Ndryshimin e shprehur në përqindje ose shumë reale, me të cilën mesatarja e ponderuar e vlerës normale e tejkalon mesataren e ponderuar të çmimit të eksportit në Kosovë;

1.12. Industria Vendore Kosovare - Të gjithë prodhuesit Kosovar të produktit të ngjashëm apo prodhuesit e Kosovës, të cilët së bashku prodhojnë produktin e ngjashëm i cili përbën më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të prodhimit të përgjithshëm të produktit të ngjashëm në Kosovë, në qoftë se një prodhues Kosovar i produktit të ngjashëm është i lidhur me një eksportues ose importues, ose nëse ai vet është importues i produktit nën hetim, atëherë për qëllimin i këtij përkufizimi ai mund të mos konsiderohet të jetë anëtar i industrisë së Kosovës; industria e brendshme e Kosovës nuk ka të drejtë për një procedim antidamping apo anti-subvencion kur prodhuesit e Kosovës shprehimisht mbështetësin llogarinë proceduese për më pak se njëzet e pesë përqind (25%) të produktit të ngjashëm të prodhuar nga industria vendore e Kosovës si tërësi;

1.13. Palë të interesuara - Eksportuesit, importuesit dhe prodhuesit e huaj të produktit nën hetim, apo shoqatat e biznesit apo ato tregtare, nëse shumica e anëtarëve të tyre janë prodhues të produktit nën konsideratë, eksportuesit ose importuesit e produktit nën hetim; qeveritë e vendeve eksportuese; prodhuesit e produktit të ngjashëm në Kosovë; shoqatat e biznesit apo ato tregtare të Kosovës, nëse shumica e anëtarëve të tyre janë prodhues të produktit të ngjashëm në Kosovë dhe Shoqatat Kosovare të Konsumatorëve;

1.14. Hetimi - Një hetim të kryer nga Ministria në pajtim me këtë ligj, për të përcaktuar praninë, shkallën dhe efektet e kaluara, aktuale ose të ardhshme të importeve të dampuara ose të subvencionuara në industrinë vendore të Kosovës ose në ndonjë palë tjetër të interesuar. Hetimet e ekzistencës së subvencionimit ose dampingut dhe dëmeve pasuese të tyre kryhen në të njëjtën kohë;

1.15. Periudha e hetimit - Një periudhë prej së paku gjashtë (6) muaj dhe zakonisht një (1) vit para dhe sa më afër të jetë e mundur dhe e përshtatshme me fillimin e procedurës për qëllim të përcaktimit të dampingut ose subvencionimit dhe dëmeve pasuese të shkaktuara;

1.16. Subvencioni - Kontributin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë financiar të siguruar nga qeveria apo ndonjë autoritet tjetër publik në vendin eksportues ose të origjinës, i cili ofron përfitim për një kompani eksportuese, ndërmarrje ose grup të ndërmarrjeve ose industrive në vendin eksportues ose të origjinës (përfituesi), siç parashikohet në nenin XVI të GATT 1994;

1.17. **Marzha e subvencionit** - ose shuma e përgjithshme e subvencionit- vlerën absolute të përfitimeve financiare të cilat përfituesi i ka marrë gjatë periudhës së hetimit për subvencionim;

1.18. **Dëmi** - Dëmtimin material ekonomik dhe / ose financiar për industrinë vendore të Kosovës, kërcënimin e dëmit material apo ngecjes materiale ose parandalimit të krijimit ose zhvillimit të industrisë vendore të Kosovës;

1.19. **Shuma Përfaqësuese** – Shuma e të gjitha kostove të prodhimit/përpunimit të produktit nën hetim apo atij të ngjashëm, duke përfshirë kostot administrative, kostot tjera të krijuara në veprimtari të ndërmarrjes, si dhe një fitim të arsyeshëm për prodhuesin/përpunuesin, të gjitha këto duke vepruar në kushte normale të tregut;

1.20. **Masa antidamping** - Detyrimin i cili është vendosur për importet e një produkti nën hetim që është objekt i dampingut ose i një zotimi të pranuar, me qëllim të kompensimit të ndryshimit mes çmimeve me të cilat produkti është eksportuar në Kosovë (çmimi i eksportit) dhe vlerës normale të tij, ose një vlere që do të jetë e përshtatshme për të hequr dëmin ndaj industrisë vendore të Kosovës, cilado që të jetë më e ulët;

1.21. **Masa kundërbalancuese** - Detyrimin i cili është vendosur për importet e një produkti nën hetim, i cili është subvencionuar, ose është një zotimi të pranuar, me qëllim të kompensimit të shumës totale të subvencioneve kundërbalancuese për produktin nën hetim ose vlerës që do të jetë adekuate për të hequr dëmin ndaj industrisë vendore të Kosovës, cilado që të jetë më e ulët;

1.22. **Qeveria** - Qeverinë apo cilindo autoritet ose organ tjetër publik brenda territorit të vendit të eksportit ose vendit të origjinës;

1.23. **Interesi i Kosovës** - Të gjitha interesat e ndryshme ekonomike dhe financiare të të gjitha palëve të interesuara në Kosovë të marra si tërësi në lidhje me vendosjen ose mos-vendosjen e masave anti-damping apo anti-subvencion. Nevojës për të eliminuar efektet e shtrembërimit tregtar të dampingut apo subvencionimit të dëmshëm dhe për të rivendosur konkurrencën efektive dhe të ndershme, po ashtu dhe t'i ipet vëmendje e veçantë.

KREU II

PËRCAKTIMI I DAMPINGUT

Neni 4 Masat Antidamping

Masat antidamping mund të jenë të zbatueshme për çdo produkt të dampuar, importimi dhe shitja e të cilit në Kosovë shkakton ose kërcënon të shkaktojë dëm material ndaj industrisë vendore.

Neni 5 Vlera normale

1. Në rast kur eksportuesi nuk e prodhon, përpunon ose shet produktin e ngjashëm në vend eksportues vlera normale mund të përcaktohet në bazë të çmimeve të prodhuesve ose shitësve të tjerë në atë vend.

2. Çmimet krahasuese në mes të palëve të cilët bashkëpunojnë me njëra tjetrën ose që kanë marrëveshje në mes vete mund të mos trajtohen sikur të ishin në kushte normale të tregut dhe gjithashtu mund që të mos shfrytëzohen në përcaktimin e vlerës normale, përveç nëse konstatohet se këto çmime nuk janë të ndikuara nga marrëveshja apo bashkëpunimi në mes tyre.

3. Me qëllim të përcaktimit të vlerës normale duhet të përdoret një sasi e mjaftueshme e shitjeve të produktit të ngjashëm në tregun vendor të vendit eksportues. Kjo sasi duhet të jetë së paku pesë për qind (5%) e sasisë së shitjeve të eksportit në Kosovë. Një sasi më e vogël mund të merret vetëm nëse dëshmohet se është mjaft përfaqësuese për nivelin e çmimeve në vendin eksportues dhe për një krahasim të saktë dhe të përshtatshëm.

4. Në rastet kur nuk ka fare shitje apo kur ka shitje të pamjaftueshme të produktit të ngjashëm nën kushtet e normale të tregut, apo kur për shkak të ndonjë situatë të veçantë të tregut në vendin eksportues ky vëllim i shitjes pamundëson krijimin e një baze të duhur dhe të saktë për përcaktimin e vlerës normale, atëherë vlera normale e produktit të ngjashëm do të përcaktohet në bazë të kostove të prodhimit në vendin e origjinës duke përfshirë këtu edhe një shumë të arsyeshme për shpenzime të shitjes, shpenzime të përgjithshme dhe administrative, si dhe një fitim të arsyeshëm të eksportuesit apo ndonjë prodhuesi/përpunuesi tjetër të produktit të ngjashëm.

5. Nëse një përcaktim i tillë në bazë të paragrafit 4 të këtij neni, duket të mos jetë i mundshëm ose i përshtatshëm, vlera normale duhet të bazohet në një shumë përfaqësuese të çmimeve të eksportit sipas tregut dhe kushteve normale tregtare nga ai vend në një vend të tretë të përshtatshëm dhe të krahasueshëm ose mbi ndonjë bazë tjetër të arsyeshme.

Neni 6

Trajtimi i shitjeve nën kosto

1. Kur e bën përcaktimin e vlerës normale, Ministria zakonisht merr parasysh vetëm ato shitje të bëra në kushte normale të tregut. Shitjet e produktit të ngjashëm në tregun e brendshëm të vendit eksportues ose shitjet në një vend të tretë me një çmim më të ulët se shpenzimet totale për njësi të prodhimit (fikse dhe të ndryshueshme) plus shitja, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative dhe një fitimi i arsyeshëm mund të trajtohen se nuk janë sipas kushteve normale të tregut përveç nëse Ministria përcakton se:

1.1. shitjet të tilla janë bërë vetëm për një periudhë të shkurtër kohore (jo më shumë se gjashtë (6) muaj);

1.2. shitjet të tilla janë bërë vetëm në sasi të parëndësishme;

1.3. mesatarja e ponderuar e çmimit të shitjes së transaksioneve nën hetim nuk është më e ulët se kostoja për njësi e mesatares së ponderuar ose kur vëllimi i shitjeve nën koston për njësi paraqet më pak se njëzet për qind (20%) të shitjeve që përdoren për të përcaktuar vlerën normale;

1.4. shitjet e tilla janë bërë me çmime që mbulojnë të gjitha kostot brenda një periudhe të caktuar kohore; nëse çmimet nën kosto për njësi, në kohën e shitjes janë mbi mesataren e ponderuar të kostos për njësi për periudhën e hetimit, konsiderohet se çmimet e tilla e lejojnë kthimin e të gjitha shpenzimeve.

Neni 7

Përlllogaritja e kostove në përcaktimin e vlerës normale

1. Ministria përlllogaritë kostot në bazë të shënimeve të kontabilitetit dhe të dhënave të tjera të biznesit të paraqitura nga eksportuesi ose prodhuesi nën hetim me kusht që këto të dhëna të jenë në përputhje me parimet përgjithësisht të pranura të kontabilitetit të vendit eksportues ose të vendit të origjinës dhe të reflektojnë arsyeshëm dhe saktë kostot që lidhen me produktin, si dhe shitjet e eksportit të produktit nën hetim.

2. Vlera dhe sasia e shitjes, të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative dhe të fitimit duhet të përlllogariten ose të përcaktohen në bazë të informatave dhe të dhënave në kohën e daljes së këtyre shpenzimeve dhe fitimit. Këto vlera duhet të jenë të lidhura me prodhimin dhe shitjet e produktit të ngjashëm nga eksportuesi ose prodhuesi nën hetim në kushte normale të tregut.

3. Në rastet kur shpenzimet nuk janë të pasqyruara në mënyrë të arsyeshme në kontabilitet ose në të dhënat e tjera të biznesit dhe si rrjedhojë nuk mund të përcaktohen në mënyrë korrekte dhe të saktë, ato duhet të përcaktohen:

3.1. mbi bazën e mesatares së ponderuar të vlerave reale të përcaktuara për eksportuesit apo prodhuesit e tjerë që janë objekt i hetimeve me kusht që ata të prodhojnë dhe shesin produktin e ngjashëm në tregun e brendshëm të vendit eksportues ose në vendin e origjinës, e nëse kjo nuk është e mundur;

3.2. mbi bazën e vlerave reale të zbatueshme për prodhimin dhe shitjen e të njëjtës kategori të përgjithshme të produkteve në kushte normale të tregut për eksportuesin ose prodhuesin në fjalë në tregun e brendshëm të vendit eksportues ose në vendin e origjinës, e nëse kjo nuk është e mundur;

3.3. mbi bazën e ndonjë metode tjetër të arsyeshme, duke siguruar se vlera e përcaktuar për fitim nuk e kalon fitimin zakonisht të gjeneruar nga eksportuesit apo prodhuesit gjatë shitjes së produkteve të kategorisë së njëjtë të përgjithshme në tregun e brendshëm të vendit eksportues ose në vendin e origjinës.

Neni 8

Çmimi i eksportit

1. Çmimi i eksportit duhet të jetë çmimi realisht i paguar ose që duhet të paguhet për produktin nën hetim, kur shitet për eksport nga vendi eksportues në Kosovë.

2. Në rastet kur nuk ka çmim të eksportit, ose kur ky çmim konsiderohet i gabuar, i pasaktë ose jo i besueshëm Ministria mund të llogaris dhe ta ndërton çmimin e eksportit, në bazë të:

2.1. çmimit me të cilin produktet e importuara i janë rishitur për herë të parë një blerësi të pavarur në Kosovë; ose,

2.2. ku produktet e importuara nuk i janë rishitur për herë të parë një blerësi të pavarur në Kosovë, ose nuk janë rishitur në kushte të njëjta siç ishin importuar, në ndonjë bazë të arsyeshme.

3. Në rastet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të bëhen përshtatjet në kalkulimin e çmimit të eksportit për të gjitha fitimet, shpenzimet dhe taksat e krijuara në mes të importimit dhe rishitjes në mënyrë që të krijohet një çmim i arsyeshëm dhe i besueshëm i eksportit në nivel kufitar të Kosovës.

Neni 9

Krahasimi i vlerës normale dhe çmimit të eksportit

1. Duhet të bëhet një krahasim i drejtë ndërmjet çmimit të eksportit dhe vlerës normale. Krahasimi duhet të bëhet në nivelin e njëjtë të tregtisë, normalisht në nivelin e çmimit të fabrikës, në vendin e eksportit ose në vendin e origjinës dhe sa më afër që të jetë e mundur në të njëjtën kohë dhe duke marrë parasysh të gjithë faktorët, kushtet e shitjes dhe dallimet që mund të ndikojnë në krahasueshmërinë e çmimeve kur ato janë marrë nga ndonjë palë e interesuar dhe kur demonstrohen me prova faktike. Krahasimi në çdo rast duhet të marrë në konsideratë dhe të bëjë përshtatjet për ndryshimet në karakteristikat fizike të produktit nën hetim dhe produktit të ngjashëm të përdorur për krijimin e vlerës normale, në sasi të shitjes, kostot e shitjes dhe kushtet e tjera të shitjes dhe për diferencat e valutave.

2. Faktorët për të cilët zakonisht bëhen përshtatje janë të shënuar më poshtë, ndërsa kjo listë është vetëm indikative dhe nuk mund të jetë e kufizuar vetëm në:

2.1. Karakteristikat fizike - Përshtatjet duhet të bëhen për ndryshimet në karakteristikat fizike dhe përdorimin e produkteve. Ato bëhen mbi bazën e një vlerësimi të arsyeshëm të vlerës së tregut apo perceptimin e këtyre dallimeve nga konsumatori në vendin eksportues ose në vendin e origjinës dhe në Kosovë. Përshtatjet mund të jenë po ashtu të bazuara në dallimet në kostot e prodhimit, nëse informacioni apo të dhënat mbi çmimet nuk janë në dispozicion, ose nuk janë të përshtatshme për një krahasim të saktë;

2.2. Detyrimet, kostot dhe taksat direkte dhe indirekte të importit - Përshtatjet duhet të bëhen me vlerën normale për të gjitha ndryshimet në detyrimet, kostot dhe taksat direkte dhe indirekte të importit të bartura nga produkti i ngjashëm dhe nga materialet e përfshira fizikisht në të e të cilat nuk mbledhen ose rimbursohen në lidhje me produktin nën hetim;

2.3. Zbritjet, rabatet dhe sasi të - Përshtatjet duhet të bëhen për të gjitha ndryshimet që lidhen me zbritje dhe rabate, duke përfshirë ato të dhëna për ndryshimet në sasi, nëse këto sasi janë të përcaktuara ashtu siç duhet dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me shitjet në fjalë;

2.4. Niveli i tregtisë - Përshtatjet duhet të bëhen për të gjitha ndryshimet në nivelin e tregtisë dhe shitjes dhe sistemet e shpërndarjes, duke përfshirë çdo ndryshim që mund të lindë nga Prodhuesi Origjinal i Pajisjeve ose në shitje të ngjashme. Përshtatja duhet të bëhet edhe kur në lidhje me zinxhirin e shpërndarjes në Kosovë dhe vendin eksportues ose në vendin e origjinës shihet se çmimi i eksportit, duke përfshirë një çmim të llogaritur dhe përcaktuar të eksportit, është në një nivel tregtar të ndryshëm nga ai i vlerës normale dhe se ky ndryshim ka ndikuar në krahasueshmërinë e çmimeve. Kjo duhet të demonstrohet nga ndryshimet e vazhdueshme dhe të dallueshme në funksionet e shitësve ose distributorëve dhe të çmimeve të shitësve ose distributorëve për nivelet e ndryshme të tregtisë në tregun e brendshëm të vendit eksportues ose vendit të origjinës. Shuma e përshtatjes duhet të bazohet në vlerën e ndryshimit në treg;

2.5. Shpenzimet e transportit, sigurimit, trajtimit, tregtimit, ngarkimit - shkarkimit dhe kostoja shtesë - Përshtatjet duhet të bëhen për të gjitha ndryshimet në kostot që lidhen drejtpërdrejt dhe që shkaktohen gjatë transportit të produktit nën hetim nga ambientet e eksportuesit tek blerësi i parë i pavarur, ku shpenzimet e tilla janë të përfshira në çmimet e ngarkuara. Këto kosto do të përfshijnë kostot e transportit, sigurimit, trajtimit, tregtimit, ngarkim - shkarkimit dhe të gjitha kostot ndihmëse;

2.6. Paketimi - Përshtatjet duhet të bëhen për të gjitha ndryshimet në kostot e paketimit të lidhura drejtpërdrejt dhe dala për produktin e ngjashëm dhe për produktin në hetim në vendin e eksportit ose vendin e origjinës;

2.7. Kreditë - Përshtatjet duhet të bëhen për të gjitha ndryshimet në koston e çdo kredie të dhënë për shitjen nën shqyrtim, nëse ajo është një faktor që është marrë parasysh në përcaktimin e çmimit të ngarkuar;

2.8. Kostot e shërbimeve pas-shitjes - Përshtatjet duhet të bëhen për të gjitha ndryshimet në kostot direkte të ofrimit të garancive, sigurimeve, asistencës teknike dhe shërbimeve të tjera të pas-shitjes, të parashikuara me Ligj ose me kontratë të shitjes së produktit të ngjashëm;

2.9. Tarifat - Përshtatjet duhet të bëhen për të gjitha ndryshimet në tarifën e paguar për agjentët e shitjes ose agjencitë e tjera që merren me komercializimin e produktit të ngjashëm në lidhje me shitjen nën konsideratë;

2.10. Faktorët e tjerë - Përshtatjet duhet të bëhen për të gjitha ndryshimet në faktorët e tjerë që nuk janë të përmendur më lartë nëse është demonstruar se ata ndikojnë në krahasueshmërinë e çmimeve.

Neni 10 Marzha e dampingut

1. Marzha e dampingut zakonisht përcaktohet duke krahasuar gjatë periudhës së hetimit mesataren e ponderuar të vlerave normale me mesataren e ponderuar të çmimeve të eksportit të të gjitha transaksioneve ose duke krahasuar vlerën normale individuale me çmimin e eksportit individual për çdo transaksion.

2. Marzha e dampingut gjithashtu mund të përcaktohet duke marrë mesataren e ponderuar të vlerës normale dhe duke e krahasuar atë me të gjitha çmimet e transaksioneve individuale të eksportit në Kosovë. Kjo duhet të bëhet vetëm në qoftë se ka një model të çmimeve të eksportit i cili ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në mes blerësve të ndryshëm në Kosovë apo periudhave kohore.

3. Kur marzhat e dampingut ndryshojnë, mund të përcaktohet një mesatare e ponderuar e të gjitha marzhave të përlogaritura të dampingut.

KREU III PËRCAKTIMI I SUBVENCIONIMIT

Neni 11 Parim i përgjithshëm

1. Detyrimi kundërbalancues mund të vendoset për qëllim të kompensimit të ndonjë subvencioni të dhënë drejtpërdrejt ose tërthorazi, për prodhimin, eksportin ose transportin e ndonjë produkti, importi, lirimi dhe qarkullimi i lirë i të cilit shkakton dëm në Kosovë.
2. Një produkt për qëllim të këtij ligji, konsiderohet i subvencionuar, nëse përfiton nga një subvencion kundërbalancues siç përcaktohet në nenet 12 dhe 13 të këtij ligji.
3. Subvencioni i tillë mund të ipet nga Qeveria e vendit të origjinës së produktit të importuar, ose nga qeveria e vendit ndërmjetës nga i cili produkti në fjalë është eksportuar në Kosovë, e i cili për qëllimet e këtij ligji njihet si 'vendi i eksportit'.
4. Pavarësisht nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, kur produktet nuk janë të importuara direkt nga vendi i origjinës, por janë eksportuar në Kosovë nga një vend ndërmjetës, dispozitat e këtij ligji duhet të jenë plotësisht të zbatueshme dhe transaksioni ose transaksionet, sipas rastit, duhet të konsiderohen sikur të kishin ndodhur në mes të vendit të origjinës dhe Kosovës.

Neni 12 Përkufizimi i subvencionit

1. Subvencioni do të konsiderohet se ekziston nëse:

1.1. ekziston një kontribut financiar nga qeveria në vendin e origjinës ose eksportit, që do të thotë, kur:

1.1.1. praktika e qeverisë përfshin një transferim të drejtpërdrejtë të fondeve (për shembull, grante, kredi, infuzion kapitali), transferet e mundshme të drejtpërdrejta të fondeve ose detyrimeve (për shembull, garanci të kredisë);

1.1.2 të ardhurat e qeverisë që ndryshe janë detyrime, falen apo thjesht nuk mbledhen (për shembull, stimujt fiskal të tillë si kreditë e taksave), në këtë drejtim, përjashtimi i një produkti të eksportuar nga detyrimet apo taksat e pranuar nga produkti i ngjashëm, kur është i destinuar për konsum të brendshëm, ose shuarja e detyrimeve ose taksave të tilla në sasi që nuk e tejkalojnë ato që janë mbledhur, nuk duhet të konsiderohet të jetë një subvencion, me kusht që të jetë dhënë një përjashtim i tillë;

1.1.3. Qeveria ofron mallra ose shërbime të tjera nga infrastruktura e përgjithshme, ose blen mallra;

1.1.4. Qeveria:

1.1.4.1. bën pagesa në një mekanizëm financues; ose,

1.1.4.2. ia beson ose drejton një organ privat për të kryer një ose më shumë lloje të funksioneve të ilustruara në nëparagrafët 1.1.1, 1.1.2 dhe 1.1.3. të këtij neni të cilat normalisht do të duhet të ishin kompetencë e qeverisë, dhe kur praktika, në asnjë kuptim real, nuk dallon nga praktikat zakonisht të ndjekura nga qeveritë; ose,

1.1.4.3. ekziston ndonjë formë e mbështetje së të ardhurave apo çmimeve brenda kuptimit të nenit XVI të GATT 1994; dhe,

1.1.4.4. kur në këtë mënyrë një kompanie, ndërmarrje, grupi ndërmarrjesh apo industrie eksportuese i është dhënë një përfitim, (në tekstin e mëtejshëm të referuar si 'ndërmarrjet e caktuara').

Neni 13

Subvencionet kundërbalancuese

1. Subvencionet i nënshtrohen masave kundërbalancuese vetëm nëse ato janë specifike.
2. Me qëllim që të përcaktohet nëse një Subvencion është specifik për ndërmarrjet e caktuara brenda juridiksionit të autoritetit dhënës, duhet të zbatohen parimet e mëposhtme:
 - 2.1. kur autoriteti i dhënies, ose legjislacioni sipas të cilit vepron autoriteti dhënies, në mënyrë eksplicite e kufizon qasjen në subvencion për ndërmarrje të caktuara, subvencioni i tillë është specifik;
 - 2.2. kur autoriteti i dhënies, ose legjislacioni sipas të cilit vepron autoriteti dhënies, përcakton kriteret apo kushtet objektive që qeverisin të drejtën për, dhe shumën e subvencionit, specifikiteti nuk ekziston, me kusht që kualifikueshmëria është automatike dhe se kriteret dhe kushtet e tilla për të respektohen në mënyrë rigorozë.
3. Kriteret apo kushte objektive për qëllim të këtij neni konsiderohen ato kriteret apo kushte të cilat janë neutrale, nuk i favorizojnë disa ndërmarrje në raport me të tjerat, dhe të cilat sipas natyrës janë ekonomike dhe sipas zbatimit janë horizontale, të tilla si numri i punonjësve apo përmasat e ndërmarrjes. Kriteret ose kushtet duhet të jenë të përcaktuara qartë me ligj, rregullore, ose dokument tjetër zyrtar, në mënyrë që të jenë në gjendje të verifikohen nëse:
 - 3.1. pavarësisht ndonjë paraqitje të jo-specifikitetit që rezulton nga zbatimi i parimeve të përcaktuara në nënparagrafët 2.1. dhe 2.2. të këtij neni nëse ka arsye për të besuar se subvencioni në fakt mund të jetë specifik, atëherë mund të konsiderohen faktorët e tjerë;
 - 3.2. faktorë të tillë janë: përdorimi i një programi subvencionesh nga një numër i kufizuar i ndërmarrjeve të caktuara, përdorimi mbizotërues nga ndërmarrjet e caktuara; dhënia e shumave të mëdha të subvencioneve në mënyrë disproporcionale për ndërmarrje të caktuara dhe mënyra në të cilën është ushtruar diskrecioni nga autoriteti i dhënies në vendimin për të dhënë një subvencion;
 - 3.3. në këtë drejtim, bazuar në nënparagrafët 3.1 dhe 3.2. të këtij paragrafi informacioni mbi shpeshtësinë me të cilën janë refuzuar apo miratuar kërkesat për subvencion dhe arsyet për vendime të tilla duhet veçanërisht të merren parasysh.
4. Nëse zbatohet paragrafi 1 i këtij neni do të merret parasysh shtrirja e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike brenda juridiksionit të autoritetit dhënës, si dhe kohëzgjatja e kohës gjatë së cilës ka vepruar programi i subvencionimit.
5. Subvencioni i cili është i kufizuar për ndërmarrjet e caktuara të vendosura brenda një rajoni të caktuar gjeografik brenda juridiksionit të autoritetit dhënës është specifik. Për qëllimet e këtij ligji vendosja apo ndryshimi i normave tatimore në përgjithësi të zbatueshme nga të gjitha nivelet e qeverisë që kanë të drejtë ta bëjnë këtë nuk konsiderohet të jetë një subvencion specifik.
6. Pavarësisht paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, subvencionet e më poshtme konsiderohen se janë specifike:
 - 6.1. Subvencionet e kushtëzuara, në ligj ose në fakt, qoftë vetëm ose si një nga disa kushte të tjera, mbi performancën e eksportit. Subvencionet në fakt konsiderohen të jenë të kushtëzuara me performancën e eksportit, kur faktet demonstrojnë se dhënia e subvencionit, pa u bërë ligjërisht e kushtëzuar me performancën e eksportit, është në fakt e lidhur me eksportimin aktual apo të pritur ose me fitimet nga eksporti. Fakti i thjeshtë se një subvencioni është akorduar për ndërmarrjet që eksportojnë, në kuptimin e kësaj dispozite nuk do të konsiderohet subvencion eksporti vetëm për këtë arsye;
 - 6.2. Subvencionet e kushtëzuara, qoftë të vetme ose si një nga disa kushte të tjera, me përdorimin e mallrave të brendshme në vend të atyre të importuara.
7. Çdo përcaktim i specifikitetit sipas dispozitave të këtij neni, duhet të provohet në mënyrë të qartë në bazë të dëshmive.

Neni 14

Përlllogaritja e shumës së subvencionit kundërbalancues

Për qëllime të këtij ligji, përlllogaritet shuma e subvencioneve kundërbalancuese të dhëna për përfituesin, në aspektin e përfitimit i cili është konstatuar se ekziston gjatë periudhës së hetimit për subvencionim. Normalisht kjo periudhë duhet të jetë viti i fundit kontabël më i afërt i përfituesit, por mund të jetë edhe ndonjë periudhë tjetër të paktën gjashtë (6) muaj para fillimit të hetimit për të cilat janë në dispozicion të dhënat e besueshme financiare dhe të dhënat e tjera relevante.

Neni 15

Përlllogaritja e përfitimit të përfituesit

1. Sa i përket përlllogaritjes së përfitimit të përfituesit, duhet të zbatohen rregullat e mëposhtme:

1.1. Investimi ne ekuitet nga ana e Qeverisë nuk konsiderohet se paraqet përfitim, përveç nëse investimi mund të konsiderohet në kundërshtim me praktikën e zakonshme të investimeve (duke përfshirë sigurimin e kapitalit të rrezikut) të investitorëve privat në territorin e vendit e origjinës dhe / ose eksportit;

1.2. Huaja nga qeveria nuk konsiderohet se paraqet përfitim, përveç nëse ekziston një diferencë ndërmjet shumës që ndërmarrja e cila merr kredi e paguan për huanë qeveritare dhe shumës që ndërmarrja do ta paguante për një hua tregtare të krahasueshme të cilën ndërmarrja mundet vërtetë ta marrë në treg. Në këtë rast përfitimi është diferenca ndërmjet këtyre dy shumave;

1.3. Garancia e kredisë nga qeveria nuk konsiderohet se paraqet përfitim, përveç nëse ekziston një diferencë ndërmjet shumës që ndërmarrja e cila merr kredi e paguan për një hua të garantuar nga qeveria dhe shumës që ndërmarrja do ta paguante për hua të krahasueshme komerciale në mungesë të garancisë qeveritare. Në këtë rast përfitimi do të jetë diferenca ndërmjet këtyre dy shumave, e rregulluar sipas ndonjë dallimi në taksa;

1.4. Ofrimi i mallrave ose shërbimeve ose blerja e mallrave nga qeveria nuk konsiderohen se paraqesin përfitim, përveç nëse është bërë ofrimi për më pak se shpërblimi adekuat ose blerja është bërë për më shumë se shpërblimi adekuat. Kualifikueshmëria e shpërblimit përcaktohet në lidhje me kushtet mbizotëruese të tregut për produktin apo shërbimin në fjalë në vendin e ofrimit ose blerjes (duke përfshirë çmimin, cilësinë, disponueshmërinë, tregtueshmërinë, transportin dhe kushtet e tjera të blerjes ose të shitjes).

2. Nëse nuk ka kriteret dhe kushtet të tilla mbizotëruese të tregut për produktin apo shërbimin në fjalë në vendin e ofrimit ose blerjes të cilat mund të përdoret si standarde të përshtatshme, atëherë do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

2.1. kriteret dhe kushtet që mbizotërojnë në vendin përkatës, do të përshtaten në bazë të kostove aktuale, çmimeve dhe faktorëve të tjerë në dispozicion në atë vend, me një sasi të duhur e cila reflekton kriteret dhe kushtet normale të tregut; ose,

2.2. kur është e përshtatshme, duhet të përdoren kriteret dhe kushtet që mbizotërojnë në tregun e një vendi tjetër ose në tregun botëror të cilat janë në dispozicion të përfituesit.

Neni 16

Dispozitat e përgjithshme për përlllogaritje

1. Shuma e subvencioneve kundërbalancuese duhet të përcaktohet për njësi të produktit të subvencionuar të eksportuar në Kosovë. Në krijimin e kësaj shume elementet e mëposhtme mund të zbriten nga subvencionin i përgjithshëm:

1.1. çdo tarifë aplikimi, ose shpenzimet e tjera të bëra në mënyrë që të kualifikohen për, ose për të marrë subvencionin;

1.2. taksat e eksportit, detyrimet ose pagesat e tjera të ngarkuara mbi eksportin e produktit në Kosovë të destinuara posaçërisht për të kompensuar subvencionin.

2. Kur një palë e interesuar kërkon zbritje, duhet të dëshmoj se kërkesa është e arsyetuar.

3. Kur subvencioni nuk është dhënë duke iu referuar sasive të prodhuara, eksportuara apo transportuara, shuma e subvencionit kundërbalancues duhet të përcaktohet duke alokuar vlerën e përgjithshme të subvencionit, sipas rastit, mbi nivelin e prodhimit, shitjes apo eksportet të produkteve në fjalë gjatë periudhës së hetimit për subvencionim.

4. Kur subvencioni mund të jetë i lidhur me blerjen ose blerjen e ardhshme të aseteve fikse, shuma e subvencionit kundërbalancues duhet të përlogaritet duke shpërndarë subvencionin nëpër një periudhë e cila pasqyron amortizimin normal të këtyre aseteve në industrinë në fjalë. Shuma e përlogaritur në këtë mënyrë që i atribuohet periudhës së hetimit, duke përfshirë edhe atë që rrjedh nga asetet fikse të blera përpara kësaj periudhe, do të alokohet siç përshkruhet në paragrafin 2. të këtij neni kur asetet janë jo-zhvlerësues, subvencioni duhet të vlerësohet si një hua pa interes, dhe duhet të trajtohet në përputhje me nenin 15 nënparagrafi 1.2. të këtij ligji.

5. Kur subvencioni nuk mund të ndërlidhet me blerjen e aseteve fikse, shuma e përfitimit të marrë gjatë periudhës së hetimit në parim duhet t'i atribuohet kësaj periudhe, dhe të alokohet siç përshkruhet në paragrafin 2 të këtij neni përpos nëse rrethanat e veçanta nxjerrin një atribuim justifikues për një periudhë tjetër.

Neni 17

Metoda e përlogaritjes së shumës së subvencionit

1. Shuma e subvencionit të përfituesit për produktin në hetim do të përlogaritet për çdo subvencion ose program subvencioni të hetuar, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni. Totali i këtyre shumave për subvencion ose program subvencioni do të jetë shuma totale e subvencionimit të prodhuesit ose eksportuesit për këtë produkt.

2. Për të përlogaritur shumën e subvencionimit të produktit nën hetim për disa përfitues të një subvencioni ose programi të caktuar të subvencionit, Ministria përcakton:

2.1. në fazën e parë, vlerën e përgjithshme të subvencioneve të dhëna përfituesit nga një subvencion ose program i caktuar i subvencionit dhe datën e pranimit;

2.2. në fazën e dytë, pjesën e vlerës totale të subvencionit që do t'i ngarkohet periudhës së hetimit të subvencionit;

2.3. në fazën e tretë, vlerën e përgjithshme të asaj shitje të përfituesit të cilës do t'i atribuohet periudha e hetimit të subvencionit.

Neni 18

Përlogaritja e shumës së subvencionit specifik

1. Ministria i përcakton detyrimet të subvencionimit specifike për çdo përfitues për produktin nën hetim.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet kur numri i përfituesve është shumë i madh, atëherë Ministria mund të kufizojë hetimin në një numër të arsyeshëm të përfituesve ose produkteve nën hetim të cilët mund të hetohen në mënyrë të arsyeshme.

3. Çdo përzgjedhje e përfituesve ose e llojeve të produkteve që është bërë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, bëhet pas konsultimeve me përfituesit.

4. Në rastet kur Ministria e kufizon hetimin në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, e përcakton vlerën specifike të subvencionit për çdo përfitues të cilët vullnetarisht dhe me kohë paraqesin dokumentet e nevojshme për hetim.

KREU IV

PËRCAKTIMI I DËMIT

Neni 19 Përkufizimi i dëmit

1. Dëmi nga importet e dampuara ose të subvencionuara duhet të përcaktohet jo vetëm kur shkaktohen dëmtime materiale ekonomike ose financiare drejtpërdrejt në industrinë vendore të Kosovës, por edhe kur ka një kërcënim nga ai dëm ose ka një ngecje materiale të krijimit apo zhvillimit të një industrie vendore të Kosovës.

2. Përcaktimi i dëmit duhet të bazohet në prova dhe duhet të përfshijë një ekzaminim objektiv dhe të drejtë të:

2.1. vëllimit të importeve të dampuara ose të subvencionuara, veçanërisht në qoftë se vëllimi ka shënuar një rritje të konsiderueshme në kriteret absolute ose relative në raport me prodhimin industrial ose konsumin e produktit të ngjashëm në Kosovë;

2.2. ndikimit të mëvonshëm të këtyre importeve të dampuara ose të subvencionuara në industrinë vendore të Kosovës. Ky ndikim duhet të përcaktohet në bazë të informacioneve ekzistuese ose potenciale ekonomike dhe / ose financiare, të dhënave dhe treguesve, të tilla si rënia e shitjes, çmimeve dhe / ose rezultateve, parandalimi i rritjes së çmimeve, zvogëlimi në aksionet e tregut, produktiviteti, dhe / ose fitimet, ose një ndikim negativ në rezerva, punësim, paga, likuiditet, rrjedhë të parasë së gatshme, kthim nga investimi, shfrytëzim të kapaciteteve, inventarë, rritje, aftësi për të rritur kapitalin ose investimet.

Neni 20 Shqyrtimi i efektit të importeve të dampuara ose të subvencionuara në çmime

1. Për ta vlerësuar ndikimin e mallrave nga importet e dampuara ose të subvencionuara në çmime në tregun e Kosovës, Ministria veçanërisht shqyrton:

1.1. nëse ka pasur një ulje të madhe të çmimeve nga importet e dampuara ose të subvencionuara në krahasim me çmimet për produktin e ngjashëm të industrisë vendore të Kosovës; ose,

1.2. nëse ka një rënie të madhe të çmimeve ose parandalim të rritjes së çmimeve, të cilat përndryshe do të kishin ndodhur.

Neni 21 Vlerësimi kumulativ

1. Kur importet e një produkti në Kosovë nga më shumë se një vend janë të njëjtën kohë subjekt të një hetimi anti-damping respektivisht anti-subvencion, efektet e importeve të tilla mund të vlerësohen vetëm në mënyrë kumulative, nëse përcaktohet nga Ministria që:

1.1. Marzha e dampingut apo subvencionit për importin e çdo vendi është e barabartë ose më e lartë se dypërqind (2%) *ad valorem* për damping dhe e barabartë ose më e lartë se një përqind (1%) *ad valorem* për hetimet e subvencionit dhe vëllimi i importeve nga secili vend nuk është i papërfillshëm (pjesëmarrja minimale në tregun e Kosovës prej një përqind (1%); dhe,

1.2. Vlerësimi kumulativ i efekteve të importit nga çdo vend është i përshtatshëm për shkak të kushteve të konkurrencës në mes të vetë produkteve të importuara dhe në mes të produkteve të ngjashme vendore të Kosovës.

Neni 22

Shqyrtimi i ndikimit të importeve të dampuara ose të subvencionuara

1. Shqyrtimi i ndikimit të importeve të dampuara ose të subvencionuara në industrinë vendore të Kosovës duhet të vlerësohet nga Ministria dhe të përfshijë një vlerësim të të gjithë treguesve përkatës ekonomik dhe faktorëve që ndikojnë në gjendjen e industrisë vendore të Kosovës, të tillë si:

1.1. rënia aktuale dhe potenciale e shitjeve, fitimeve, të prodhimit, pjesëmarrjes në treg, produktivitetit, kthimit nga investimet dhe shfrytëzimit të kapaciteteve;

1.2. faktorët aktual dhe potencial që ndikojnë në çmimet vendore;

1.3. efektet aktuale dhe potenciale negative për lëvizjen e mallrave, punësimit, pagave, rritjes, dhe aftësinë për të rritur kapitalin ose investimet;

1.4. madhësia e marzhave aktuale të dampingut ose subvencionit.

2. Ministria i vlerëson efektet e importeve të dampuara ose të subvencionuara në lidhje me prodhimin dhe shitjet e produktit të ngjashëm, kur të dhënat e disponueshme e lejojnë identifikimin e atij produkti, sipas procesit të prodhimit dhe fitimit të industrisë vendore të Kosovës.

3. Nëse identifikimi i produktit të tillë nuk është i mundur, atëherë efektet e importeve të dampuara ose të subvencionuara duhet të vlerësohen duke shqyrtuar prodhimin e grupit ose gamës më të afërt të produkteve që përfshin produktin e ngjashëm për të cilin është e mundur të merren informacionet dhe të dhënat e nevojshme.

Neni 23

Kërcënimi i dëmit material

1. Kërcënimi i dëmit material duhet të bazohet vetëm në fakte dhe kërcënimi i dëmit material duhet të parashikohet qartë dhe të jetë i pashmangshëm.

2. Në përcaktimin e fakteve që tregojnë një kërcënim të dëmit material, duhet të merren në konsideratë faktorët e përmendur në nenin 22 të këtij ligji dhe faktorët e mëposhtëm:

2.1. normat e rëndësishme të rritjes së importeve të dampuara ose të subvencionuara, që tregojnë gjasat e importeve të mëtejme të rritura në mënyrë të ndjeshme;

2.2. rëniet në nivelin e çmimeve të importeve të atilla që në një masë të konsiderueshme do të kanë një ndikim mbi çmimet e ardhshme (shkurtimin e çmimeve, depresionin e çmimeve apo shtypjen e çmimeve) në tregun e Kosovës dhe ndoshta do të rrisin kërkesën industriale të konsumatorëve apo përdoruesve për importe të mëtejshme;

2.3. kapacitetin e mjaftueshëm lirisht të disponueshëm të prodhimit të eksportuesit ose një rritje të pashmangshme në kapacitetin e atillë që do të tregonte për një rritje të importeve të dampuara ose të subvencionuara në tregun vendor të Kosovës, megjithatë duhet të merren parasysh edhe tregjet e tjera të eksportit për të thithur ndonjë eksport shtesë;

2.4. kapacitetin e prodhimit, inventarët dhe tregjet e tjera të eksportit të produktit nën hetim në vendin eksportues ose në vendin e origjinës.

3. Shqyrtimi i këtyre faktorëve duhet të çojë në përfundimin se importet e mëtejme të dampuara ose të subvencionuara janë të pashmangshme dhe është e qartë se pa masa mbrojtëse do të pësojnë dëme materiale.

Neni 24

Ngecja materiale e krijimit ose zhvillimit të industrisë së Kosovës

1. Dëmi mund të krijohet edhe nëse një prodhim i produktit të ngjashëm në Kosovë nuk ekziston akoma në një

shkallë të konsiderueshme. Në mënyrë që të krijohet një ngecje e tillë materiale e krijimit ose zhvillimit të një industrie të Kosovës duhet të ekzistojnë indikacione të qarta se në të ardhmen e afërt është gati për tu krijuar dhe/ose zhvilluar një prodhim i produktit të ngjashëm në Kosovë. Ngecja materiale duhet të bazohet në fakte.

2. Gjithashtu duhet të konstatohet se efekti i importeve të dampuara ose të subvencionuara vonon në krijimin ose zhvillimin e një industrie të Kosovës materialisht dhe substancialisht e ngecur apo braktisur.

3. Tregues për ngecje të tillë mund të jenë vonesat e konsiderueshme ose braktisja e miratimit të vendimeve apo planeve të detajuara dhe të provuara të investimeve, prodhimit, kostove, fuqisë punëtore, komercializimit apo marketingut që do të merreshin ose të viheshin në praktikë pa importe të dampuara ose subvencionuara.

Neni 25 **Lidhja shkak-pasojë**

1. Ministria verifikon dhe përcakton ekzistimin apo mosekzistimin e lidhjes shkak-pasojë midis eksporteve të dampuara ose të subvencionuara dhe dëmit material, kërcënimit të dëmit material apo ngecjes materiale të krijimit ose zhvillimit të industrisë vendore të Kosovës. Duhet të demonstrohet se importet e dampuara ose të subvencionuara janë duke e shkaktuar këtë dëm material ndaj industrisë vendore të Kosovës. Kjo duhet të përfshij një demonstrim që vëllimi dhe / ose nivelet e çmimeve të importeve të dampuara në fjalë janë përgjegjëse për dëmin e tillë material. Në këtë drejtim transaksionet e pa-dampuara ose pa-subvencionuara duhet të shpërfillen.

2. Ministria, përveç eksporteve të dampuara ose të subvencionuara, shqyrton edhe faktorë të tjerë që në të njëjtën kohë mund ta dëmtojnë industrinë vendore të Kosovës, në mënyrë që të sigurohet se dëmi i shkaktuar nga këta faktorë të tjerë nuk u atribuohet importeve të dampuara ose të subvencionuara.

3. Këta faktorë të tjerë mund të jenë:

3.1. sasia dhe çmimi i importeve të pa-dampuara ose pa-subvencionuara;

3.2. ulja e kërkesës ose ndryshimet në modelet e konsumit të Kosovës;

3.3. praktikat kufizuese tregtare, dhe konkurrenca në mes të prodhuesve vendor Kosovar dhe prodhuesve të huaj;

3.4. zhvillimet e reja teknologjike; dhe,

3.5. performanca e eksportit të bërë dhe produktiviteti i ulët i industrisë vendore të Kosovës në krahasim me eksportuesit në fjalë.

KREU V

ORGANI HETUES

Neni 26 **Ministria dhe Komisioni**

1. Ministria është organi hetues për hetimin e dampingut, subvencionimit, dëmeve të tyre dhe interesit të Kosovës. Ministria gjatë hetimit të saj dhe në vlerësimin e rezultateve të gjetjeve të saj, si dhe për zbatimin e këtij ligji mbështetet nga ana e Komisionit.

2. Komisioni duhet të përbëhet nga përfaqësuesit të institucioneve të mëposhtme:

2.1. Ministria përkatëse për Tregti dhe Industri Kryesues;

- 2.2. Ministria përkatëse e Ekonomisë dhe Financave;
- 2.3. Ministria përkatëse e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 2.4. Ministria përkatëse e Energjisë dhe Minierave;
- 2.5. Ministria përkatëse e Punëve të Jashtme;
- 2.6. Ministria përkatëse e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- 2.7. Shërbimi Doganor i Kosovës.

3. Anëtarët e Komisionit duhet të propozohen nga Ministritë përkatëse dhe do të emërohen nga Ministri/ja i/e Ministrisë përkatëse për Tregti dhe Industri.

4. Komisioni vendimet i merr më shumicë të thjeshtë votash.

KREU VI

HETIMI

Neni 27

Kushtet për paraqitjen e një kërkesë

1. Hetimi për të përcaktuar ekzistencën, shkallën dhe efektin, nivelin e çfarëdo importi të dyshuar si i dampuar ose i subvencionuar, duhet të iniciohet nga Ministria pas konsultimit të Komisionit, pas një kërkesë me shkrim nga çdo person fizik apo juridik, apo nga ndonjë shoqatë që nuk ka domosdoshmërisht personalitet juridik e që vepron në emër të industrisë vendore të Kosovës.

2. Në raste të veçanta, Ministria mund të fillojë hetimin me nismën e saj vetanake pas konsultimeve me Komisionin.

3. Kushtet për paraqitjen e një shkrese nga ose në emër të industrisë vendore të Kosovës dhe përmbajtja e formularit të kërkesës, duhet të rregullohet përkufizohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 28

Vendimi për fillimin e hetimit

1. Pas shqyrtimit dhe verifikimit të informatave të ofruara në kërkesë (ankesë), Ministria, me një raport të vlerësimit të saj i paraqet ato për vlerësim dhe konsultim pranë Komisionit. Para marrjes së vendimit për fillimin e hetimit Ministria dhe/ose Komisioni mund të kërkojnë informacione shtesë nga parashtruesit e kërkesës. Ministria vendos për hapjen e një hetimi pas këshillimit me Komisionin.

2. Kur Ministria merr vendim për të hapur një hetim pa kërkesë me shkrim nga ose në emër të industrisë vendore të Kosovës, atëherë ky vendim duhet të bazohet në informacione, dëshmi dhe të dhëna të mjaftueshme mbi dëmin material të dampingut ose subvencionit, dhe lidhjen shkakësore, në përputhje me Kreun II, III dhe IV të këtij ligji.

3. Kërkesa për fillimin e një hetimi, duhet të refuzohet nga Ministria, pas konsultimit të Komisionit, atëherë kur ka informacione ose të dhëna të pamjaftueshme për të justifikuar hapjen e një procedure.

4. Hetimi nuk do të hapet ndaj vendeve eksportuese importet të cilave në Kosovë paraqesin një pjesëmarrje në treg prej më pak se një përqind (1%), përveç nëse dhe në rastin e një ankese kundër disa vendeve eksportuese, kur këto vende së bashku përbëjnë më shumë se tre përqind (3%) të konsumit të brendshëm të Kosovës.

5. Hetimi në bazë të një kërkesë duhet të fillohet vetëm nëse përcaktohet se:

5.1 kërkesa me shkrim nga industria vendore e Kosovës është dorëzuar në pajtim me këtë ligj; dhe,

5.2 niveli i mbështetjes për kërkesën është i barabartë me ose më shumë se njëzet e pesë përqind (25%) të prodhimit total të produktit të ngjashëm të prodhuar nga industria vendore e Kosovës.

6. Do të konsiderohet se kërkesa është bërë nga ose në emër të industrisë vendore të Kosovës vetëm nëse është mbështetur nga:

6.1. ose Prodhuesit Kosovar prodhimi i të cilëve përbën baras ose më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të prodhimit total të produktit të ngjashëm; ose,

6.2. nëse kundërshtimi i shprehur për aplikimin e prodhuesve të Kosovës është më pak se prodhimi i këtyre prodhuesve që e mbështesin kërkesën.

7. do kërkesë në përputhje me dispozitat e këtij neni, mund të tërhiqet përpara se të fillon hetimi dhe në këtë rast do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare.

8. Më së shumti një muaj pas dorëzimit të kërkesës ankesës Ministria vendos për hapjen ose mos hapjen e procedurës.

9. Kur Ministria vendos të mos fillojë një hetim, atëherë për këtë fakt parashtuesi i kërkesës duhet të njoftohet me shkrim. Ky njoftim është i hapur për shqyrtim gjyqësor.

10. Ministria kërkon nga Komisioni mendimin e tij për të filluar ose për të mos filluar një hetim në lidhje me damping apo subvencionim brenda dy (2) javësh pas dorëzimit të kërkesës ankesës nga ana e industrisë vendore të Kosovës. Kur Ministria ose Komisioni kërkojnë informata shtesë nga parashtuesi i kërkesës, ky afat mund të zgjatet deri në një (1) muaj.

11. Ministria nuk do ta fillojë hetimin për produktin e importuar, nëse është konstatuar se:

11.1. në rast të dampingut, marzha e dampingut është më pak se dy përqind (2%);

11.2. në rastin e subvencionimit shuma e subvencioneve është më pak se një përqind (1%).

Neni 29

Njoftimi për fillimin e hetimit

1. Kur Ministria merr vendim për të filluar një hetim ajo është e detyruar të njoftojë Komisionin për këtë fakt dhe gjithashtu duhet t'i informojë palët e interesuara, siç është e përcaktuar në nenin 3 nënparagrafi 1.13 të këtij ligjit.

2. Fillimi i hetimit duhet të publikohet në Gazetën Zyrtare.

3. Përmbajtja e njoftimit të referuar në paragrafin 2 të këtij neni duhet të përcaktohet me akt nënligjor.

4. Hetimi duhet të fillojë nga data e publikimit të referuar në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 30

Kohëzgjatja e hetimeve

Ministria duhet t'i mbyllë hetimet mbi dyshimet për importe të dampuara ose të subvencionuara më së largu një (1) vit pas fillimit të tyre.

Neni 31 **Dosja publike dhe e drejta e informimit**

1. Për secilin hetim Ministria e krijon një dosje publike në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e informacionit konfidencial, e cila mund të ndryshohet kohë pas kohe, duke përfshirë:

1.1. raportet publike në lidhje me hetimin;

1.2. materialet, përfshirë pyetësorët, përgjigjet në pyetësorë dhe informacionet me shkrim që i janë dorëzuar Ministrisë apo Komisionit nga cilido burim tjetër;

1.3. informacionet e tjera të hartuara ose të marra nga Ministria apo Komisioni, duke përfshirë ndonjë raport për verifikimin e kryer; dhe,

1.4. të gjitha dokumentet e tjera që konsiderohen të jenë të ligjshme për informim publik.

2. Kjo dosje duhet të vihet në dispozicion të palëve të interesuara dhe të publikut në të gjitha fazat e hetimit, dhe në rrjedhën e çdo procedure gjyqësore.

Neni 32 **Hetimi**

1. Pas fillimit të procedurës, Ministria do të fillojë një hetim në Kosovë dhe, sipas nevojës, në vendin eksportues ose të origjinës. Një hetim i tillë do të mbulojë dampingun respektivisht subvencionimin, dhe dëmin e tyre, dhe këto duhet të hetohen njëkohësisht, në Kosovë, interesi i Kosovës mund të hetohet po ashtu.

2. Me qëllim të konstatimit përfaqësues, duhet të përzgjidhet një periudhë hetimi e cila:

2.1. në rast të dampingut ose subvencionimit zakonisht duhet të mbulojë deri në dymbëdhjetë muaj duke përfunduar sa më afër datës së fillimit të procedimit që të jetë e mundur, informacionet në lidhje me periudhën e mëvonshme pas kësaj periudhë të hetimit, normalisht nuk do të merren parasysh;

2.2. në rastin e dëmtimit zakonisht do të mbulojë minimum tre (3) vjet.

3. Ministria do të dërgojë palëve pyetësorë që mbulojnë dampingun ose subvencionin dhe dëmet e tyre. Palëve që marrin këta pyetësorë duhet tu ipen të paktën dyzet e pesë (45) ditë për tu përgjigjur.

4. Afati kohor për eksportuesit do të llogaritet nga data e pranimit të pyetësorit, i cili për këtë qëllim duhet të konsiderohet të ketë qenë pranuar një javë nga dita në të cilën i është dërguar të palës nën hetim ose është transmetuar tek përfaqësuesi adekuat diplomatik i vendit të origjinës dhe/ose eksportit.

5. Afati dyzet e pesë (45) ditor mund të zgjatet, duke marrë parasysh afatet e hetimit, me kusht që pala të tregon shkakun për shtyrjen e tillë, në bazë të rrethanave të veçanta të tij.

6. Pyetësorët duhet të plotësohen në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës.

7. Sipas kërkesës, duhet të ofrohen mundësitë për importuesit, eksportuesit dhe industrinë vendore të Kosovës dhe ku është e përshtatshme, Qeverinë e vendit të origjinës dhe/ose eksportit ose ndonjë palë tjetër të interesuar, të takohen ato palë që kanë interesa të kundërta, në mënyrë që të mund të paraqiten këndvështrimet e kundërta dhe argumentet e ofruara akuzuese. Ofrimi i mundësive të tilla duhet të marrë parasysh nevojën për të ruajtur konfidencialitetin dhe komoditetin për palët. Nuk duhet të ketë asnjë detyrim për asnjërën palë të marrë pjesë në takim, dhe dështimi për të bërë këtë nuk duhet të paragjykoj rastin e asaj pale. Informacioni gojor i dhënë sipas këtij paragrafi, duhet të merret parasysh nga Ministria për aq sa është i konfirmuar më pas me shkrim.

8. Në bazë të kërkesës me shkrim palët e interesuara mundën t'i inspektojnë të gjitha informatat e vëna në dispozicion të Ministrisë nga secila palë në një hetim e cila është relevante për prezantimin e rasteve të veta dhe që

nuk janë konfidenciale, dhe që përdoren në hetim. Pala e tillë e interesuar mund të përgjigjet në informacionet e tilla dhe komentet e tyre duhet të merren parasysh kurdo që ato janë të arsyetuara sa duhet në përgjigje.

9. Informacioni i cili është ofruar nga palët e interesuara dhe mbi bazën e të cilit mund të bazohen gjetjet duhet të shqyrtohet nga Ministria për korrektësinë dhe saktësinë e tij për aq sa është e mundur.

10. Gjatë hetimit të subvencionit, Ministria duhet t'i ofrojë Qeverisë së vendit të origjinës dhe/ose të eksportit një mundësi të arsyeshme për të vazhduar konsultimet me qëllim të qartësimit të gjendjes faktike dhe të arrijnë në një zgjidhje të dakorduar reciprokisht.

Neni 33 **Seanca shqyrtuese**

1. Me kërkesë me shkrim të çdo pale të interesuar, Ministria duhet të mbajë një seancë shqyrtuese në të cilën të gjitha palët e interesuara mund të paraqesin informacione dhe argumente. Seanca do të mbahet më së voni gjashtëdhjetë (60) ditë para datës së propozuar për vendimin përfundimtar.

2. Sipas kërkesës, Ministria duhet të krijojë palëve të interesuara, mundësinë për tu takuar, me qëllim që të shprehen pikëpamjet e kundërta dhe të prezantohen argumentet e kundërta.

3. Palët e interesuara që duan të përfshihen në seancën shqyrtuese, duhet ta informojnë Ministrinë për emrat e përfaqësuesve dhe dëshmitarëve që do të paraqiten në seancë, shtatë (7) ditë para datës së mbajtjes të seancës.

Neni 34 **Marrja e mostrave**

1. Në rastet kur numri i ankuesve, eksportuesve ose importuesve, lloji i produkteve ose shitjeve ose transaksioneve është i madh, hetimi mund të kufizohet në:

1.1. një numër të arsyeshëm të palëve, produkteve ose transaksioneve duke përdorur mostra të cilat janë statistikisht të vlefshme në bazë të informatave në dispozicion në kohën e përzgjedhjes; ose,

1.2. të vëllimit më të madh përfaqësues të prodhimit, shitjes apo eksporteve të cilat mund të hetohen në mënyrë të arsyeshme brenda kohës që është në dispozicion.

2. Vendimi për përzgjedhjen e palëve, llojeve të produkteve apo transaksioneve të bëra sipas këtij neni duhet të merret nga Ministria, edhe pse duhet t'i ipet preferencë përzgjedhjes së një mostre në konsultim me, dhe me pëlqimin e palëve të interesuara, me kusht që palët e tilla janë të njohura dhe kanë lënë në dispozicion informacion të mjaftueshëm brenda tri (3) javësh nga fillimi i hetimit, për të mundësuar përzgjedhjen e një mostre përfaqësuese.

3. Në rastet kur shqyrtimi është kufizuar në përputhje me këtë nen, duhet të përlogaritet një diferencë individuale e marzhave të dampingut ose subvencionit për çdo eksportues apo prodhues i cili fillimisht nuk është përzgjedhur e që paraqet informacionin e nevojshëm brenda afateve kohore të parashikuara në këtë ligj, me përjashtim kur numri i eksportuesve ose prodhuesve është aq i madh sa që shqyrtimet individuale do të jenë padrejtësisht një barrë dhe do të parandalojnë përfundimin e hetimeve në kohë të përshtatshme.

4. Aty ku Ministria ka vendosur të marrë mostrën dhe ku ka një shkallë mos-bashkëpunimit nga disa ose të gjitha palët të përzgjedhura të cilat ka gjasa të ndikojnë materialisht në rezultatin e hetimit, mund të përzgjidhet një mostër e re. Megjithatë, në qoftë se vazhdon një shkallë materiale e mos-bashkëpunimit ose nëse nuk ka kohë të mjaftueshme për të përzgjedhur një mostër të re, duhet të zbatohen dispozitat përkatëse të mos-bashkëpunimit.

Neni 35 **Mos-bashkëpunimi, informacionet e pasakta dhe çorientuese**

1. Në rast se ndonjë prej palëve të interesuara, refuzon qasjen, ose ndryshe nuk jep informacionin e kërkuar dhe

të nevojshëm ose nuk respekton afatet kohore të përcaktuara në këtë ligj ose në mënyrë të konsiderueshme pengon hetimin, atëherë përfundimet dhe rezultatet mund të bëhen në bazë të fakteve të disponueshme.

2. Kur është gjetur se cilado palë e interesuar ka dhënë informacion të pasaktë ose çorientues, ai informacion nuk duhet të merret parasysh dhe rezultatet mund të bëhen në bazë të fakteve të disponueshme.

3. Palët e interesuara duhet të bëhen të vetëdijshme për pasojat e mos-bashkëpunimit apo dhënies së informacioneve të pasakta ose mashtruese.

4. Dështimi për të dhënë me postë elektronike nuk do të konsiderohet se përbën mos-bashkëpunimin, me kusht që pala e interesuar të tregojë se paraqitja e përgjigjes siç kërkohet do të rezultojë në një barrë të paarsyeshme shtesë ose kosto të paarsyeshme shtesë.

5. Kur informacioni i paraqitur nga pala e interesuar nuk është ideal në të gjitha aspektet megjithatë nuk duhet të shpërfilllet, me kusht që mangësitë nuk janë të atilla që të shkaktojnë vështirësi të panevojshme për të arritur në një mënyrë të arsyeshme të saktë tek një gjetje dhe se informacioni i duhur është dorëzuar në kohën e duhur dhe është i verifikueshëm, dhe se pala ka vepruar në mënyrën më të mirë në bazë të aftësisë së saj.

6. Nëse prova apo informacioni nuk është pranuar, pala ofruese duhet të informohet menjëherë për arsyet dhe duhet t'i jepet një mundësi për të siguruar shpjegime të mëtejshme brenda afatit të specifikuar kohor. Nëse shpjegimet konsiderohen të pakënaqshme, arsyet për refuzimin e provave ose informacioneve të tilla duhet të zbulohen dhe të jepen në gjetjet e publikuara.

7. Nëse përcaktimet, duke përfshirë ato në lidhje me marzhën e dampingut ose subvencionit, janë të bazuara në dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, duke përfshirë informacionin e ofruar në ankesë, ato duhet, aty ku është e mundur, të praktikohen dhe duke marrë parasysh afatet e hetimit, të kontrollohen duke u referuar në informatat nga burimet e tjera të pavarura të cilat mund të jenë në dispozicion, të tilla si listat e publikuara të çmimeve, statistikat zyrtare të importit dhe kthimet e doganës, apo informacionet e marra nga palët e tjera të interesuara gjatë hetimit.

8. Nëse një palë e interesuar nuk bashkëpunon, apo bashkëpunon vetëm pjesërisht, ashtu që në këtë mënyrë informacioni përkatës nuk është ofruar, rezultati mund të jetë më pak i favorshëm për palën sesa të kishte bashkëpunuar.

Neni 36

Zbulimi i informatave

1. Palët e interesuara mund të kërkojnë zbulim të informacioneve të rëndësishme dhe fakteve thelbësore dhe detajet të konsiderueshme themelore dhe mbi bazën e të cilave janë vendosur masat e përkohshme. Kërkesa duhet t'i drejtohet Ministrisë me shkrim menjëherë pas paraqitjes së detyrimeve të përkohshme dhe zbulimi duhet të bëhet me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur pas kësaj.

2. Palët e interesuara mund të kërkojnë një zbulim përfundimtar të informatave të rëndësishme, të fakteve themelore dhe detajeve dhe të vlerësimeve në bazë të cilave ka për qëllim të vendosë masat përfundimtare ose ndërprerjen e procedimit. Kërkesa duhet t'i drejtohet Ministrisë me shkrim dhe duhet të pranohet jo më vonë se një muaj pas vendosjes së masave të përkohshme. Në rastet kur masa e përkohshme nuk është zbatuar, palët e interesuara do të kenë mundësinë për të kërkuar zbulimin përfundimtar brenda afateve kohore të përcaktuara nga Ministria.

3. Zbulimi përfundimtar duhet të bëhet me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe të paktën një muaj para se të merret ndonjë vendim përfundimtar.

4. Paraqitjet e bëra pas zbulimit përfundimtar do të merren parasysh vetëm nëse janë pranuar nga Ministria brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga Ministria, e cila duhet të jetë të paktën dy (2) javë.

5. Pasi që Ministria i përfundon hetimet, pas konsultimit me Komisionin, lëshon një vendim përfundimtar, i cili duhet të bëhet publik duke përfshirë arsyet e marrjes së ati vendimi, dhe duke pasur parasysh mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.

6. Vendimi përfundimtar publikohet në Gazetën Zyrtare. Vendimi gjithashtu i'u dërgohet palëve të interesuara.

Neni 37 Verifikimet

1. Ministria, kur e gjykon të arsyeshme mund të ndërmarrë veprime të kontrollit, inspektive dhe verifikime të të dhënave nga të gjitha palët e interesuara, që kanë të bëjnë me interesat e dampingut, subvencioneve, dëmeve dhe interesave të Kosovës. Gjithashtu mund të kryejë vizita verifikuese për të shqyrtuar të dhënat dhe për të verifikuar të dhënat dhe informacionet e dhëna.
2. Me qëllim të verifikimit të informacioneve të mbledhura dhe për të marrë informacione ato shtesë, Ministria, nëse e gjykon të nevojshme, mund të kryejë hetime edhe në vende të tjera, me kusht që ndërmarrjet në fjalë të japin pëlqimin e tyre dhe Qeveritë e vendeve në fjalë të jenë të njoftuara zyrtarisht dhe të mos ngrenë asnjë kundërshtim. Autoritetet e vendit eksportues duhet të njoftohet për emrat dhe adresat e ndërmarrjeve që do të vizitohen dhe datat e vizitave.
3. Ministria e përgatit raportin për verifikimin e të dhënave për çdo kompani. Ky raport do të jetë plotësisht në dispozicion të kompanisë, ndërsa një version jo-konfidencial do të depozitohet në dosjen publike.
4. Kompanitë e interesuara do të informohen në lidhje me natyrën e informacionit dhe të të dhënave të cilat do të verifikohen gjatë vizitës. Kërkesat e tjera për informata dhe verifikim të tyre mund të bëhen gjatë vizitave.

Neni 38 Konfidencialiteti

1. Informacioni dhe të dhënat e marra nga palët e interesuara duhet të përdoren vetëm për arsyet për të cilat janë kërkuar.
2. Informacioni konfidencial nuk do të bëhet i njohur për publikun ose ndonjë palë tjetër të interesuar pa lejen me shkrim nga burimi i këtij informacioni konfidencial.
3. Informacioni dhe të dhënat duhet të konsiderohen konfidenciale kur:
 - 3.1. nga natyra e tyre, shpalosja e informatave apo të dhënave të tilla do të ketë një ndikim të konsiderueshëm negativ apo efekt mbi personin i cili ka dorëzuar informacionin ose për personin nga i cili është marrë informacioni; dhe,
 - 3.2. informacioni është marrë mbi bazën e konfidencialitetit të palëve dhe nëse për këtë kërkesë konfidencialiteti janë treguar arsye të forta.
4. Palët e interesuara që kanë ofruar informacion konfidencial duhet gjithashtu të paraqesin një përmbledhje jo-konfidenciale. Në raste të veçanta, palët mund të tregojnë me shkrim arsyet se pse një përmbledhje e tillë jo-konfidenciale nuk është e mundur.
5. Informacioni dhe të dhënat nuk duhet të konsiderohen konfidenciale kur kërkesa për konfidencialitet nuk është e justifikuar. Në një rast të tillë dhe kur ofruesi nuk e miraton publikimin e informacionit dhe të dhënave në çdo formë, informacioni mund të shpërfillet.

KREU VII PËRFUNDIMI I HETIMIT

Neni 39 Detyrimet e përkohshme

1. Ministria mund të vendosë detyrime të përkohshme, nëse hetimi është iniciuar në pajtim me dispozitat e Kapitullit VI të këtij ligji, dhe në qoftë se vendosja e detyrimeve të përkohshme do të parandalonte parashikimet e dëmtimit e mëtejshëm të industrisë vendore të Kosovës dhe se detyrimet e përkohshme janë në interes të Kosovës.
2. Detyrimet e përkohshme mund të merren në formë të detyrimeve shtesë të importit ose të një depozitë sigurie në para apo obligacione, duke mos e kaluar marzhën e vendosur të dampingut ose subvencionit.
3. Pagesa detyrimeve të tilla të përkohshme antidamping ose kundërbalancuese është kusht për qarkullimin e lirë të produktit nën hetim në Kosovë.
4. Detyrimet e përkohshme duhet të vendosen jo më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë, por jo më vonë se nëntë (9) muaj pas fillimit të hetimeve.
5. Detyrimet e përkohshme anti-damping dhe kundërbalancuese nuk mund ta kalojnë marzhën e vendosur të dampingut apo të subvencionit, dhe duhet të jenë më të ulëta se kjo marzhë nëse një detyrim aq i ulët është i mjaftueshëm për të eliminuar dëmin e shkaktuar ndaj industrisë vendore të Kosovës.
6. Detyrimet e përkohshme normalisht duhet të zbatohen për një periudhë që nuk tejkalon gjashtë (6) muaj. Me kërkesë të eksportuesve, Ministria pas konsultimit me Komisionin mund të zgjasë periudhën e zbatimit të detyrimeve të përkohshme, por jo më shumë se nëntë (9) muaj.

Neni 40 Zotimet

1. Me kusht që të jetë bërë një përcaktim i përkohshëm pohues i dampingut ose subvencionimit dhe dëmeve të tyre si dhe veprimi mbrojtës është në interes të Kosovës, Ministria, pas konsultimit me Komisionin, mund të pranojë oferta të kënaqshme vullnetare të zotimeve sipas të cilave:

1.1. ose për hetime anti-damping eksportuesi zotohet t'i rishikojë çmimet e veta, apo të ndërpresë eksportet me çmime të dampuara dhe nëse Komisioni është i kënaqur që efekti dëmtues i dampingut është eliminuar në këtë mënyrë; ose,

1.2. Për hetime anti- subvencion:

1.2.1. vendi i origjinës dhe / ose eksportit pajtohet të eliminojë ose kufizoj subvencionin ose të marrë masa të tjera në lidhje me efektet e tij; ose,

1.2.2. cilido eksportues zotohet të rishikojë çmimet e veta, ose të ndërpresë eksportet në Kosovë për aq kohë sa eksportet e tilla përfitojnë nga subvencionet kundërbalancuese, në mënyrë që Komisioni të jetë i kënaqur se në këtë mënyrë është eliminuar efekti dëmtues i subvencioneve.

2. Në një rast të tillë dhe për aq sa kohë sa zotimet e tilla të jenë në fuqi, detyrimet e vendosura të përkohshme ose përfundimtare nuk duhet të zbatohen për importet përkatëse të produktit në fjalë të prodhuar nga eksportuesit e përmendur në zotime.
3. Rritjet e çmimeve gjatë zotimeve të tilla nuk duhet të jenë më të larta sesa është e nevojshme për të kompensuar dampingun ose shumën e subvencioneve kundërbalancuese dhe do të duhej të ishin më të ulëta në qoftë se rritjet të tilla do të ishin adekuate për të larguar dëmtimin ndaj industrisë vendore të Kosovës.

4. Palëve të cilat ofrojnë një zotim duhet t'ju kërkohet të ofrojnë një version jo-konfidencial të një zotimi të tillë, në mënyrë që ai të mund të vihet në dispozicion të palëve të interesuara në hetim.

5. Kur një zotim është pranuar para masave përfundimtare, hetimi i dampingut ose subvencionimit dhe dëmeve normalisht duhet të përfundojnë. Në një rast të tillë, nëse është bërë një përcaktim negativ i dampingut, subvencionimit, ose dëmit, zotimet duhet të skadojnë automatikisht, përveç në rastet kur një përcaktim i tillë është për shkak në pjesë të madhe të ekzistencës së një zotimi. Në raste të tilla, mund të kërkohet që një zotim të ruhet për një periudhë të arsyeshme. Në rast se është bërë një përcaktim pohues i dampingut, subvencionimit dhe dëmtimit, zotimi do të vazhdojë në përputhje me kushtet e tij dhe dispozitat e këtij ligji.

6. Çdo shtet ose eksportues nga i cili janë pranuar zotimet është e nevojshme që në mënyrë periodike të ofrojë informacione përkatëse për plotësimin e një zotimi të tillë, si dhe për të lejuar verifikimin e informacioneve dhe/ose të dhënave përkatëse. Mospërmbushja e kërkesave të tilla konsiderohet si shkelje të zotimit.

7. Në rast të shkeljes ose tërheqjes së zotimeve nga cilado palë e zotimit, ose në rast të tërheqjes së pranimi të zotimit nga Ministria, pas konsultimit me Komisionin, pranimi i zotimit duhet të tërhiqet dhe duhet të zbatohen detyrimet e përkohshme ose përfundimtare.

Neni 41 Ndërprerja pa masa

1. Pas konsultimit me Komisionin, në rast se tërhiqet kërkesa për masa Ministria duhet menjëherë ti ndërpresë hetimet pa vendosur ndonjë detyrim, përveç nëse Ministria pas konsultimit me Komisionin, vendos ndryshe në interes të Kosovës. Hetimi duhet gjithashtu të ndërpritet kur Ministria pas konsultimit me Komisionin vendos që masat mbrojtëse janë të panevojshme.

2. Hetimi gjithashtu duhet të ndërpritet menjëherë nëse Ministria, pas konsultimit me Komisionin është e bindur se nuk ka të dhëna të mjaftueshme të dampingut ose subvencionit dhe dëmtimit që justifikojnë vazhdimin e hetimit ose kur Ministria pas konsultimit me Komisionin konstaton se marzhat e dampingut ose subvencionit janë minimale, siç përcaktohet në paragrafin 11 të nenit 28 të këtij ligji, ose kur vëllimi i importeve aktuale ose potenciale të dampuara ose të subvencionuara është i papërfillshëm, siç parashikohet në paragrafin 4 të nenit 28 të këtij ligji.

Neni 42 Njoftimi publik për përfundimin e hetimeve pa vendosje të detyrimeve

Ministria, pas konsultimit me Komisionin, është e detyruar të lëshojë një njoftim publik për përfundimin e hetimit pa vendosjen e detyrimeve, duke marrë parasysh arsyet që çuan në këtë vendim dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial.

KREU VIII VENDOSJA DHE MBLEDHJA E DETYRIMEVE ANTIDAMPING DHE KUNDËRBALANCUESE

Neni 43 Pajtueshmëria me rregullën e detyrimit më të ulët

1. Ministria, pas shqyrtimit të fakteve që përcaktojnë ekzistencën e dampingut ose subvencionimit dhe pasojat e dëmeve të tyre, dhe duke marrë parasysh interesat e Kosovës, si dhe pas konsultimit të Komisionit, duhet të vendosë për vendosjen e detyrimeve përfundimtare anti-damping dhe kundërbalancuese. Në rastet kur janë të vendosura detyrimet e përkohshme, Ministria, pas konsultimit me Komisionin, vendosë detyrime përfundimtare jo më vonë se në ditën e fundit të vlefshmërisë së masave të përkohshme.

2. Detyrimet përfundimtare anti-damping dhe kundërbalancuese nuk mund ta kalojnë marzhën e përcaktuar të dampingut apo të subvencionit dhe duhet të jenë më të ulëta se kjo marzhë, nëse një detyrim i tillë i ulët është i mjaftueshëm për të eliminuar dëmin e shkaktuar ndaj industrisë vendore të Kosovës. Në qoftë se dampingu ose subvencioni ka pushuar së ekzistuari ose nëse janë tërhequr subvencionet ose kur është demonstruar se subvencionet nuk japin ndonjë përfitim për eksportuesit e përfshirë atëherë nuk duhet të vendoset asnjë masë.

3. Në shqyrtimin nëse një detyrim më i ulët është i mjaftueshëm Ministria duhet të marrë në mënyrë të veçantë parasysh nivelin e çmimit të shkurtuar nga importet e dampuara ose të subvencionuara dhe / ose nivelin e arsyeshëm të fitimit të nevojshëm për industrinë vendore të Kosovës për shitjet e saj në tregun e Kosovës.

Neni 44

Mos-diskriminimi dhe individualizimi

1. Detyrimet anti-damping ose kundërbalancuese duhet të vendosen në shumat përkatëse në çdo rast, në baza jo-diskriminuese, për të gjitha importet e produktit nën hetim nga të gjitha burimet që gjendet se dampojnë dhe që përfitojnë nga subvencionet kundërbalancuese dhe në këtë mënyrë shkaktojnë dëm, përveç për importet nga këto burime nga të cilat janë pranuar zotime sipas kushteve të këtij ligji.

2. Akti nënligjor për vendosjen e detyrimit duhet të specifikojë detyrimin për çdo eksportues ose furnizues, ose në raste të jashtëzakonshme në qoftë se individualizimi i tillë është i pazbatueshëm, vendin eksportues të furnizimit në fjalë.

3. Kur hetimi është i kufizuar në shqyrtimin e një mostre të eksportuesve, çdo detyrim anti-damping ose kundërbalancues i vendosur për importet nga eksportuesit ose prodhuesit që janë paraqitur, por nuk ishin të përfshirë në shqyrtimin e mostrës nuk duhet të tejkalojë sasinë mesatare të ponderuar të marzhave të dampingut ose subvencioneve kundërbalancuese të përcaktuara për palët në mostër. Për qëllime të këtij paragrafi, çdo marzhë ose shumë zero dhe minimale e dampingut ose e subvencioneve kundërbalancuese ose marzhat ose shumat e dampingut ose subvencioneve kundërbalancuese të vendosura për kompanitë jo-bashkëpunuese nuk duhet të merren parasysh.

4. Detyrimet individuale duhet të zbatohen për importet nga çdo eksportues apo prodhues për të cilën është për-llogaritur marzha individuale e dampingut ose shuma e subvencionimit.

5. Asnjë produkt nuk mund të jetë në të njëjtën kohë objekt i dy detyrimeve, atij antidamping dhe kundërbalancues, për arsye se kanë të bëjnë me një situatë të njëjtë që vjen nga dampingu ose nga subvencionimi.

Neni 45

Detyrimet retroaktive

1. Detyrimet e përkohshme dhe përfundimtare antidamping dhe kundërbalancuese normalisht zbatohen vetëm për produktet që janë lëshuar në qarkullim të lirë në Kosovë, pas kohës kur janë marrë vendimet e përkohshme ose përfundimtare.

2. Kur është vendosur një detyrim i përkohshëm dhe kur faktet e provuara përfundimisht tregojnë ekzistencën e dampingut respektivisht subvencioneve edhe dëmet prej tyre, Ministria, pas konsultimit me Komisionin, duhet të vendosë, pavarësisht nëse do të vendoset një detyrim përfundimtar anti-damping ose kundërbalancues se çfarë proporcioni i detyrimit të përkohshëm duhet përfundimisht të mblihet.

3. Në rastet kur gjetjet përfundimtare tregojnë kërcënim për dëm apo ngecje, do të lëshohet çdo shumë e përkohshme dhe detyrimet përfundimtare mund të vendosen vetëm mbi produktet në të cilën një është bërë përcaktimi përfundimtar i dëmit apo ngecjes.

4. Nëse detyrimi përfundimtar anti-damping ose kundërbalancues është më i lartë se detyrimi i përkohshëm, diferenca nuk duhet të mblihet në mënyrë retroaktive. Nëse detyrimi përfundimtar është më i ulët se detyrimi i përkohshëm, diferenca midis dy detyrimeve duhet të lirohet. Kur përcaktimi përfundimtar është negativ (nuk ka damping, subvencionim apo dëm apo kur interesi i Kosovës nuk bën thirrje për veprim), detyrimi i përkohshëm nuk konfirmohet dhe do të duhej të lirohet në tërësi.

5. Detyrimi përfundimtar anti-damping ose kundërbalancues mund të vendoset për produktet të cilat janë futur në qarkullim të lirë në Kosovë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë para datës së zbatimit të masave të përkohshme por jo para fillimit të hetimit, me kusht që importet të jenë regjistruar dhe që importuesve të interesuar iu është dhënë një mundësi për të paraqitur komentet e tyre, dhe:

5.1. kur ekzistojnë rrethana kritike, ku për produktin e dumpuar ose të subvencionuar në fjalë është shkaktuar dëmi, të cilin është e vështirë për ta riparuar, nga importet masive, në një periudhë relativisht të shkurtër kohore, të një produkti që përfiton nga dampingu apo subvencionet kundërbalancuese sipas kushteve të këtij ligji; dhe,

5.2. konsiderohet e nevojshme, për të vlerësuar detyrimet anti-damping ose kundërbalancuese në mënyrë retroaktive në këto importe në mënyrë që të pengojnë përsëritjen e dëmit;ose,

5.3. për produktin nën hetim, ka një histori të dampingut ose subvencionimit mbi një periudhë të zgjatur kohe ose se importuesi ishte në dijeni ose duhet të ketë qenë në dijeni për damping ose subvencion për sa i përket shtrirjes së dampingut apo subvencionimit dhe dëmit të dyshuar ose të gjetur; ose,

5.4. përveç nivelit të importeve të cilat kanë shkaktuar dëm gjatë periudhës së hetimit, ka një rritje të mëtejshme të konsiderueshme në importet të cilat, në aspektin e kohës dhe vëllimit të tyre dhe rrethanave të tjera, ka të ngjarë të dëmtojnë seriozisht efektin përmirësues të detyrimit përfundimtar anti-damping apo kundërbalancues që do të zbatohet.

6. Në rastet e shkeljes ose tërheqjes së zotimeve, detyrimet përfundimtare mund të vendosen mbi mallrat që kanë hyrë për qarkullim të lirë jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë përpara zbatimit të masave të përkohshme, me kusht që importet të jenë të regjistruara dhe se çdo vlerësim i tillë retroaktiv nuk duhet të zbatohet për importet e hyra para shkeljes ose tërheqjes së zotimit.

KREU IX

KOHËZGJATJA, SHQYRTIMI, RIMBURSIMI, SUSPENDIMI, MASHTRIMI

Neni 46

Kohëzgjatja

1. Detyrimet Anti-damping dhe kundërbalancuese mbeten në fuqi vetëm për sa kohë dhe në atë masë që është e nevojshme për të neutralizuar dhe luftuar dampingun ose subvencionin që ka shkaktuar dëm material ndaj industrisë vendore të Kosovës dhe përderisa ato janë në interes të Kosovës.

2. Çdo detyrim përfundimtar anti-damping apo kundërbalancues duhet të skadojë pas një maksimumi prej pesë (5) vitesh nga vendosja e tij apo pesë (5) vjet pas datës së shqyrtimit të fundit të plotë në lidhje me dampingun, subvencionimin ose dëmin dhe interesat e Kosovës, përveç në rastet kur shqyrtimi (shqyrtimit i skadimi) konkludon se skadimi ose ndërprerja e këtyre detyrimeve mund të çojë në vazhdimin apo rishfaqjen e dampingut, subvencioneve ose dëmit.

Neni 47

Shqyrtimi i afatit të skadimit

1. Shqyrtimi i afatit të skadimit fillon nëse ka prova të mjaftueshme se skadimi ose ndërprerja e detyrimeve mund të çojë në një vazhdim apo rishfaqje të dampingut apo të subvencioneve. Kjo tregohet nga informacionet dhe të dhënat mbi vazhdimësinë e dampingut apo subvencioneve ose në bazë të informacionit ose të dhënave se largimi i dëmit është shkaktuar vetëm ose pjesërisht për shkak të ekzistencës së detyrimeve të paraqitura në Ministri nga cilado palë e interesuar.

2. Ministria, pas konsultimit me Komisionin, mund ta fillojë një procedurë të shqyrtimit të detyrimeve të vendosura me nismën e vet ose me kërkesë me shkrim nga ose në emër të industrisë vendore të Kosovës, dhe detyrimi do të mbetet në fuqi derisa të silltet vendimi përfundimtar për këtë shqyrtim. Kohëzgjatja e procedurës së shqyrtimit nuk duhet të kalojë një (1) vit.

3. Kërkesa duhet të bëhet në Ministri dhe duhet të përmbajnë dëshmi të mjaftueshme se skadimi i masave do të kishte të ngjarë të rezultojë me një vazhdim apo rishfaqje të dampingut ose subvencionimit dhe dëmeve të tyre.

4. Gjatë hetimeve në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, Ministria duhet t'ua lejojë importuesve, eksportuesve, përfaqësuesve të vendit eksportues dhe të industrisë vendore të Kosovës të plotësojnë, kundërshtojnë, apo komentojnë mbi çështjet e renditura në kërkesën e shqyrtimit, duke marrë parasysh të gjitha informacionet e dokumentuara dhe faktin se skadimi i detyrimeve mund të çojë në gjasat e vazhdimit apo rishfaqjes përsëritjes së dumpingut ose subvencioneve dhe dëmit.

5. Jo më vonë se katër (4) muaj para skadimit të masave dhe pas këshillimit me Komisionin, Ministria e publikon në Gazetën Zyrtare një njoftim për largimin e shpejtë të detyrimeve antidamping ose kundërbalancuese, në mënyrë që të lejojë që industria vendore e Kosovës të paraqes një kërkesë për shqyrtim.

6. Njoftimi për skadimin e masave publikohet në Gazetën Zyrtare.

7. Masat e vendosura në bazë të kësaj procedure të skadimit mund të zgjasin deri në pesë (5) vjet.

Neni 48 **Shqyrtimi i ndërmjetëm**

1. Nevoja për vazhdimin e vendosjes së masave mund të shqyrtohet, kur është e arsyeshme. Në këtë drejtim, Ministria, pas konsultimit me Komisionin, mund të fillojë procedurën e shqyrtimit të ndërmjetëm, me vet iniciativë, në çdo kohë. Një shqyrtim i ndërmjetëm mundet gjithashtu të kërket nga ose në emër të industrisë vendore të Kosovës ose ndonjë pale tjetër të interesuar pas kalimit të një periudhe të arsyeshme kohore, dhe të paktën një vit pas vendosjes së masave përfundimtare anti-dumpingut ose kundërbalancuese.

2. Kërkesa duhet t'i drejtohet Ministrisë dhe të përmbajë dëshmi të mjaftueshme se vazhdimi i vënies së masave nuk është edhe më tej i nevojshëm për të kompensuar dumpingun ose subvencionimin dhe/ose që dëmtimi ka pak gjasa të vazhdojë apo të përsëritet nëse masat hiqen ose ndryshohen apo se masat ekzistuese nuk janë ose nuk janë edhe më tej të mjaftueshme për të luftuar dumpingun ose subvencionimin dhe dëmin e shkaktuar prej tyre.

3. Nëse Ministria konstaton gjatë shqyrtimit të masave antidumping ose kundërbalancuese, pas këshillimit me Komisionin, se masat nuk janë edhe më tej të nevojshme, ata do largohen menjëherë. Nëse Ministria konstaton gjatë shqyrtimit të masave antidumping ose kundërbalancuese, pas këshillimit me Komisionin, se masat nuk janë edhe më tej të mjaftueshme, ato do të përshtaten në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Masat e vendosura në bazë të kësaj procedure të shqyrtimit të ndërmjetëm mund të zgjasin deri në pesë (5) vite me kusht që shqyrtimi i ndërmjetëm i ka mbuluar si dumpingun / subvencionimin dhe dëmin po ashtu edhe interesin e Kosovës. Nëse kjo nuk ka ndodhur, ato skadojnë në datën e skadimit të masave fillestare.

Neni 49 **Shqyrtimi i kërkesës të eksportuesve/importuesve të ri**

1. Një eksportues, produktet e të cilit janë objekt i detyrimeve përfundimtare antidamping ose kundërbalancuese dhe i cili nuk është hetuar individualisht gjatë procedurës hetimore, jo për arsye të refuzimit për të bashkëpunuar, mund të kërkojë shqyrtim në mënyrë që t'i bëhet një shqyrtim individual. Kërkesa duhet t'i drejtohet Ministrisë, të jetë me shkrim dhe duhet të dokumentohet plotësisht sa i përket vlerës normale ose shumës së subvencionit kundërbalancues si dhe çmimeve aktuale apo të ardhshme të eksportit të tij. Industrisë së brendshme të Kosovës duhet t'i jepet mundësia për të dhënë komentet e saj në lidhje me këtë kërkesë.

2. Për procedurat e hetimit sipas paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 50 **Shqyrtimi i kërkesës pas marrjes së masës**

1. Shqyrtimi i kërkesës mund të iniciohet nga Ministria, pas konsultimit me Komisionin, nëse ndonjë palë e interesuar paraqet, zakonisht jo më herët se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të masave, dëshmi të mjaftueshme, pas periudhës fillestare të hetimit dhe para ose pas vendosjes së masave, se çmimet e eksportit janë ulur ndjeshëm, ose se nuk ka pasur asnjë lëvizje, apo lëvizje të pamjaftueshme të çmimeve të rishitjes ose çmimet e mëvonshme

të shitjes së produktit të importuar në Kosovë. Ministria do të shqyrtojë gjatë hetimit nëse masat në fuqi kishin efekt në çmimet e lartpërmendura ose nëse kanë ekzistuar faktorë të tjerë të cilët kanë çuar në këtë situatë.

2. Nëse hetimi i ndërmarrë nga Ministria dëshmon se akuzat janë të sakta, detyrimet ekzistuese anti-dumping respektivisht kundërbalancuese, mund të rriten nga Ministria, pas konsultimit me Komisionin, në mënyrë që të arrihet ngritja e nevojshme e çmimit për të mënjeluar dëmin ndaj industrisë vendore të Kosovës; megjithatë, niveli i rritur i detyrimit nuk duhet të tejkalojë marzhën e dampingut ose shumën e subvencioneve kundërbalancuese që mund të rillogariten në bazë të fakteve të reja.

3. Për procedurat e hetimit sipas këtij neni do të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 51 **Rikthimi i fondeve- Rimbursimi**

1. Importuesi mund të kërkojë rikthimin e detyrimeve të grumbulluara nga organet kompetente nëse Ministria, pas konsultimit me Komisionin, përcakton se marzha e dampingut ose marzha e subvencionit, në bazë të së cilës janë paguar detyrimet, është eliminuar ose reduktuar në një nivel që është më i ulët sesa detyrimi në fuqi.

2. Importuesi duhet të paraqesë, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas datës kur detyrimi i kërkuar për rikthim është mbledhur nga Ministria, një kërkesë me shkrim të dokumentuar në mënyrë të duhur për rikthimin e shumës së detyrimeve që ishte paguar.

3. Kërkesa duhet të përmbajë informacionin e dokumentuar për shumën e kërkuar të rikthimit të detyrimeve antidamping ose kundërbalancuese për atë periudhë, si dhe dokumentet e plota doganore në lidhje me llogaritjen e pagesës së një shume të tillë.

4. Ministria shqyrton kërkesën dhe heton rastin. Nëse eksportuesi ose prodhuesi dështon të sigurojë dëshmitë brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, kërkesa do të refuzohet nga Ministria, pas konsultimit me Komisionin.

5. Bazuar në kërkesën për rikthim, Ministria, pas konsultimit me Komisionin, gjatë hetimeve, do të vendosë nëse dhe deri në të cilën shumim do të bëhet rikthimi.

6. Rikthimin e detyrimeve normalisht do të zhvillohet brenda dymbëdhjetë (12) muajve dhe në çdo rast jo më vonë se tetëmbëdhjetë (18) muaj nga data e kërkesës për rikthim. Çdo rikthim, i bazuar në të dhëna të duhura nga importuesi i produktit, i cili është objekt i detyrimeve antidamping ose kundërbalancuese, bëhet brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e vendimit për rikthim.

Neni 52 **Pezullimi**

1. Masat e vendosura sipas këtij ligji, mund të pezullohen në interes të Kosovës me një vendim të Ministrisë, pas këshillimit me Komisionin, për një periudhë jo më të gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj. Pezullimi mund të zgjatet për një periudhë tjetër, jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj, nëse Ministria, pas konsultimit me Komisionin, vendos për zgjatje mbi bazën e provave të mjaftueshme.

2. Masat mund të pezullohet vetëm në bazë të një kërkesë me shkrim dhe plotësisht të dokumentuar, drejtuar Ministrisë nga pala e interesuar duke siguruar dëshmi të faktorëve dhe kushteve të theksuara sipas paragrafi 3 të këtij neni.

3. Masat mund të pezullohet vetëm kur kushtet e tregut të Kosovës kanë ndryshuar përkohësisht në atë masë sa që dëmi në industrinë vendore të Kosovës do të ishte i pamundur të rikthehet si pasojë e pezullimit, dhe me kusht që industrisë vendore të Kosovës i është dhënë mundësi për të dhënë komentet e saj dhe me kusht që këto komentet janë marrë parasysh.

4. Masat munden, në çdo kohë dhe pas konsultimit të palëve të interesuara, të rivendosen nga Ministria, pas konsultimit me Komisionin, në qoftë se arsyeja për pezullim nuk është edhe më tej e zbatueshme.

Neni 53 Mashtrimi

1. Në bazë të një kërkesë me shkrim të drejtuar Ministrisë nga një palë e interesuar, detyrimet antidamping ose kundërbalancuese, siç janë përcaktuar në përputhje me këtë ligj, mund të zgjaten nga Ministria, pas konsultimit me Komisionin, për produktet e ngjashme apo për disa pjesë të tyre, të cilat importohen në Kosovë nga një vend i tretë, kur ndodhë mashtrimi i përbushjes së masave në fuqi.

2. Mashtrimi do të përkufizohet si një ndryshim në modelin e tregtisë midis vendeve të treta dhe Kosovës apo në mes të kompanive individuale në vend të cilat i nënshtrohen masave dhe Kosovës, i cili buron nga një praktikë, proces apo punë për të cilën nuk ekziston shkas i mjaftueshëm apo arsyetim ekonomik përveç vendosjes së detyrimeve.

3. Praktika, procesi apo puna e përmendur sipas paragrafit 2 të këtij neni përfshin, *inter alia*, modifikimin e vogël të produktit në fjalë, për të ndikuar që ai produkt të klasifikohet në kodet doganore të cilat normalisht nuk janë objekt i masave, me kusht që modifikimi nuk i ndryshon karakteristikat e tij thelbësore; dërgesa e produktit i cili është objekt i masave nëpërmjet vendeve të treta; si dhe riorganizimi i modeleve dhe kanaleve të shitjes në vend nga ana e eksportuesve ose prodhuesve. Modifikim duhet të bëhet në mënyrë që në fund produktet të eksportohen në Kosovë nëpërmjet prodhuesve që përfitojnë nga një normë më të ulët e detyrimeve individuale sesa ajo që zbatohet për produktet e prodhuesve.

KREU X INTERESI I KOSOVËS

Neni 54 Interesat e Kosovës

1. Përcaktim se a kërkon interesi i Kosovës një ndërhyrje anti-dumping ose kundërbalancuese do të duhej të bëhej nga Ministria, pas konsultimit me Komisionin, dhe do të duhej të jetë i bazuar në një vlerësim të të gjitha interesave të ndryshme ekonomike të të gjitha palëve të interesuara të marra në tërësi; një përcaktim në bazë të këtij neni duhet të bëhet vetëm kur të gjitha palëve iu është dhënë mundësia për t'i shfaqur pikëpamjet e tyre. Gjatë një shqyrtimi të tillë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojës për t'i eliminuar efektet shtrembëruese tregtare të dampingut apo subvencionimit të dëmshëm si dhe rivendosjes së konkurrencës efektive dhe të ndershme në dobi të konsumatorëve.

2. Masat, siç përcaktohen në bazë të dampingut ose subvencionimit dhe dëmtimit të konstatuar nga këto të fundit, nuk mund të zbatohen kur Ministria, pas konsultimit me Komisionin, del në përfundim të qartë se nuk është në interes të Kosovës që të aplikojë ose zbatoj masa të tilla.

3. Industria vendore e Kosovës, importuesit dhe shoqatat përfaqësuese të tyre, organizatat përfaqësuese të përdoruesve dhe organizatat përfaqësuese të konsumatorëve duhet tu japin informacione në lidhje me këtë.

4. Ministria shqyrton informacionet të cili parashtrohen në mënyrë të duhur si dhe masën deri ku ato janë reprezentative. Informatat do të duhej të merren parasysh vetëm kur janë të mbështetura me dëshmi të dokumentuara.

KREU XI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 55 Shqyrtimi gjyqësor i vendimeve përfundimtare

Për të gjitha vendimet përfundimtare të marra në përputhje me këtë ligj mund të paraqitet ankesë në Gjykatën Themelore për Çështje Administrative të Republikës së Kosovës.

Neni 56 Aktet nënligjore

Për zbatimin e këtij ligji, Ministria nxjerr aktet nënligjore brenda gjashtë muajsh (6) nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 57 Dispozitat shfuqizuese

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 03/L-097 për masat anti dumping dhe masat kundërbalancuese.

Neni 58 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-240
06 maj 2014**

Shpallur me dekretin Nr. DL-025-2014, datë 21.05.2014 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga